REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 31 .07.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

1. **Sa është numri i studentëve të pajisur me Kartën e Studentit sipas viteve 2021, 2022, 2023, 2024, 2025, 2026?**

Bashkia Durrës ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit "Për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit, delegimin dhe administrimin e kartës së studentit nga Bashkia Durrës" me nr. 995 prot., datë 10.02.2023, protokolluar me tonën mr nr. 1732/1 prot., datë 13.02.2023. Midis Bashkisë Durrës dhe UAMD u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit "Për përfituesit e kartës së studentit" me nr. 1282/16 prot., datë 31.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1850/2 prot., datë 06.08.2025.
Shpërndarja e kartave të studentit për studentët Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës ka filluar në Shtator 2025 (viti shkollor 2025-2026). Numri i studentëve të pajisur me kartën e studentit aktualisht është 1143 studentë. Në vitin e ri shkollor 2026-2027 pritet të shtohet numri I kartave të shpërndara.

2. **Sa karta janë aktive aktualisht?**

Aktualisht janë aktive 1143 kartat e shpërndara.

3. **Sa është fondi i akorduar për Kartën e Studentit sipas viteve 2021, 2022, 2023, 2024, 2025, 4. 2026?**

Në zbatim të marrëveshjes së sipërcituar me UAMD, Bashkia Durrës ka kryer procedurën: "Platforma dixhitale për produktin "Karta e studentit" si dhe mirëmbajtje sistemi me vlerën 4,911,000 (katër milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë, në vitin 2025.

4. Cilat kategori shërbimesh përfshihen?

Kategorite e sherbimeve qe perfshihen jane:
Kancelari, Fotokopje, Analiza, Grafi, ushqimet e shportes te cilat do te jene me te detajuara pas nenshkrimit te marreveshjeve (sipas pikes 5)

Ndjekja e shfaqjeve artistike, vizitat ne muzete e qytetit, frekuentimi I pishines se qytetit, ndjekja e aktiviteteve sportive (sipas pikës 6).

5. Sa biznese janë partnere?

Në kuadër të mbështetjes së studentëve të pajisur me kartë studenti, kemi zhvilluar bisedime dhe kemi arritur të biem dakort për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me disa biznese lokale për ofrimin e zbritjeve dhe lehtësirave në shërbime e produkte. Deri tani partneritetet janë arritur me: Ansi Laborator, Kancelari Dyrrahu, Extra Market, Spar Market, Big Market, Intermedica.
Gjithashtu, jemi në tratativa me operatorët e transportit publik për të arritur një marrëveshje që do të mundësonte studentëve në nevojë, të cilët janë përfitues burse dhe të pajisur me kartë studenti, përfitimin e abonimeve të autobusit me tarifa të reduktuara apo të subvencionuara. Kjo nismë synon të lehtësojë barrën financiare të studentëve dhe të përmirësojë aksesin e tyre në arsim.

6. Sa institucione publike ofrojnë shërbime me zbritje?

Për studentët që janë të pajisur me Kartë Studenti, u vendosën të ofrohen disa kategori shërbimesh me çmimet si më poshtë:

- Biblioteka Publike e qytetit tonë ofron të gjitha shërbimet pa pagesë.
- Qëndra Kulturore "Aleksandër Moisiu" për çdo ditë jave ku pagesa e biletave është 300 Lekë, për studentët reduktohet në 100 Lekë, ndërsa në fundjavë ku pagesa është 500 Lekë, për studentët është 200 lekë.
- Në rrjetin muzeal pagesa nga 100 Lekë që është aktualisht, për studentët e pajisur me kartë është pa pagesë
- Ambjenti i pishinës që ndodhet në Lagjen nr.1 të qytetit tonë, nga 200 Lekë/90 minuta që është pagesa për frekuentim, për studentët reduktohet 50%, dmth në 100 Lekë/90 minuta.
- Pallati i Sportit "Ramazan Njala" ofron pjesëmarrje në takimet sportive dhe kampionate pa pagesë.
- Ndeshjet e futbollit në stadiumin "Niko Dovana", nga 200 Lekë/bileta, për studentët reduktohet me 50%, pra do jetë 100 Lekë/bileta.

7. **A disponohen statistika mbi përdorimin e kartës sipas kategorive të shërbimeve? Nëse po na i vendosni në dispozicion.**

Deri tani të gjitha kartat e studentit janë përdorur vetëm në institucionet publike ku janë ofruar shërbimet me zbritje apo të subvencionuara.

Për të gjitha pikat e tjera të mëposhtme, Bashkia Durrës nuk disponon informacion,pasi funksion I saj janë institucionet e përkujdesjes, arsimi parashkollor, funksion I përbashkët arsimi parauniversitar (infrastrukturë dhe punonjës mbështetës), ndërsa arsimi i lartë nuk është kompetencë e Bashkisë Durrës.